



**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**  
**NDËRMJET**  
**KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT TË SHQIPËRISË**  
**DHE**  
**ENTIT SHTETËROR TË REVIZIONIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË**  
**VERIUT**

**HYRJE**

Enti Shtetëror i Revizionit i Republikës së Maqedonisë së Veriut (për më tej ESHR) dhe

Kontrolli i Lartë i Shtetit i Shqipërisë (për më tej KLSH)

më tej referuar si “Palët”,

*Duke konfirmuar vullnetin për të forcuar dhe promovuar bashkëpunimin e ndërsjellë në përputhje me praktikat e mira dhe parimet bazë të EUROSAT-t dhe INTOSAT-t;*

*Si dhe, duke u bazuar në parimet e mira të partneritetit ndërmjet institucioneve partnere me qëllim ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe promovimin e auditimit të përgjegjshëm dhe efektiv të qeverisë;*

*Kanë dakordësuar për sa më lart, të nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (për më tej referuar si “Marrëveshja”).*

## **NENI 1**

### **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është:

1. Zhvillimi i bashkëpunimit profesional dhe teknik ndërmjet Palëve bazuar në parimet dhe standardet profesionale të EUROSAT-t dhe INTOSAI-t, ku të dyja Palët janë anëtare.
2. Bashkëpunimi do të sjellë përfitim të ndërsjellë tek Palët në përpjekjet e tyre për të rritur kompetencat dhe lidhjet e tyre profesionale.
3. Bashkëpunimi ndërmjet Palëve mund të përmbajë fushat me interes të përbashkët duke përfshirë:
  - 1) shkëmbimin e eksperiencave dhe organizimin e aktiviteteve mbi çështje me interes të përbashkët, përfshirë zhvillimin e konsultimeve, seminareve, tryezave të rrumbullakta, konferencave mbi problematikat kryesore të auditimit të jashtëm;
  - 2) ndërveprimin në sferën e trajnimeve profesionale dhe përmirësimin e standardeve profesionale të stafit, brenda kuadrit në të cilin secila nga Palët, me qëllim përmirësimin e aftësive profesionale të punonjësve, me marrëveshje të ndërsjellë, fton delegacione apo të tjerë përfaqësues nga Pala tjetër, për të marrë pjesë në konferenca, seminare, trajnime dhe evente të tjera ndërkombëtare të organizuara respektivisht në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
  - 3) shkëmbimin e informacionit dhe materialeve referencë lidhur me aktivitetet e Palëve, përfshirë standardet dhe zhvillimet e metodologjisë në sferën e auditimit të jashtëm publik;
  - 4) kryerjen e auditimeve paralele, të koordinuara dhe të përbashkëta;
  - 5) të tjera drejtime dhe forma bashkëpunimi të pranuar në mënyrë të ndërsjellë.

## **NENI 2**

### **Objekti i bashkëpunimit**

Palët deklarojnë qëllimin e tyre për të zhvilluar bashkëpunimin e ndërsjellë në mënyrë që të rrisin kapacitetet profesionale dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre audituese nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave, duke marrë në konsideratë standartet ndërkombëtare të INTOSAI-t.

### **NENI 3**

#### **Forma e bashkëpunimit**

Palët angazhohen së bashku:

1. Të zbatojnë Marrëveshjen dhe të ofrojnë burimet e nevojshme. Rezultatet e bashkëpunimit zotërohen nga të dyja Palët.
2. Të bëjnë të gjitha përgatitjet e nevojshme për zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve p.sh të caktojnë personat përgjegjës për pjesëmarrjen aktive në aktivitete, si dhe të përcaktojnë kohën dhe burimet e nevojshme.

### **NENI 4**

#### **Komunikimi ndërmjet Palëve**

Të dyja Palët angazhohen të ruajnë një komunikim efektiv dhe të hapur mbi të gjitha çështjet që lidhen me aktivitetet e përbashkëta.

Kufizimet në përdorimin e materialeve specifike në pronësi të përbashkët mund të vendosen vetëm në rastet kur është caktuar para fillimit të aktiviteteve të përbashkëta.

### **NENI 5**

#### **Amendimet dhe kostot**

Palët mbulojnë shpenzimet respektive mbi aktivitetet, me përjashtim të rasteve kur është vendosur ndryshe. Amendimet dhe shtesat në Marrëveshje janë subjekt ndaj miratimit paraprak të Palëve.

### **NENI 6**

#### **Kontributi i Palëve**

Palët kontribuojnë në përgatitjen, zbatimin dhe monitorimin e progresit të aktiviteteve nëpërmjet stafit të tyre kompetent.

### **NENI 7**

#### **Përjashtimi nga përgjegjësia**

Përmbajtja e kësaj Marrëveshjeje nuk sjell detyrime për Palët dhe nuk konsiderohet si një marrëveshje ndërkombëtare apo e së drejtës publike ndërkombëtare, si dhe nuk mund të aplikohet në bazë të ligjit mbi detyrimet kontraktuale në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut.

## NENI 8

### Kohëzgjatja dhe përfundimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi pas firmosjes dhe mbetet në fuqi derisa Palët e dakordësojnë këtë. Kjo Marrëveshje përfundon nëse njëra nga Palët deklaron qëllimin për t'i dhënë fund asaj. Në këtë rast, Palët duhet të bëjnë më të mirën e tyre për të përmbyllur aktivitetet e përbashkëta, sa më shpejt të jetë e mundur.

Deri në përfundimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët i përmbahen kushteve që rrjedhin prej saj lidhur me veprimet e kryera përpara datës së përfundimit.

## NENI 9

### Ndryshimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me dakordësi ndërmjet Palëve nëpërmjet komunikimit të ndërsjellë me shkrim.

## NENI 10

### Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi nga data e firmosjes ndërmjet Palëve.
2. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nënshkruhet në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze, të gjitha me tekst autentik, të njëjtë. Në rast mosmarrëveshjeje lidhur me dispozitat e saj, versioni anglisht duhet të konsiderohet si detyrues.

Nënshkruar në Shkup, më 30 Nëntor, 2022

.....  
Kontrolli i Lartë i Shtetit i Shqipërisë



Arben Shehu

Kryetar



Enti Shtetëror i Revizionit i  
Republikës së Maqedonisë së Veriut



Maksim Acevski

Kryerevizori shtetëror

